Bashkia ne proceset e Integrimit Evropian

Sektori i Integrimit Evropian dhe Koordinimit te Ndihmes se Huaj, aktualisht ka ndermarr nje nisme per te hartuar kalendarin e aktiviteteve rinore . Ne kuader te kesaj nisme, kane filluar takimet me te rinjte e qytetit per te bashkepunuar me to ne lidhje me aktivitet qe sipas tyre ne duhet t'ja ofrojme . Me date 15 shtator u realizua nje takim me drejtuesit e shkollave te Shijakut dhe Njesive Administrative Xhafzotaj , Maminas , Gjepalaj .

Se bashku me Kryetarin e Bashkise Shijak , ne si Sektor i Integrimit Europian dhe Koordinimit te ndihmes se huaj zhvilluam nje prezantim te Sektorit perkates si dhe mundesin qe ne mund ti ofrojme te rinjeve ne aktivitete te ndryshme ne menyre qe te rinjt e qytetit tone te aktivizohen ne pune vullnetare apo aktivitete te ndyshme rinore , kulturore , sportive ne bashkepunim me shkollen si qender komunitare dhe grupit te vullnetareve te bashkise .
Ne vijim te kesaj do te nisin takimet e njepasnjeshshme me te rinjte e cdo shkolle qe perfshine Bashkia Shijak

a) EULEUS është organizata e parë në Shijak, e pavarur, joqeveritare dhe jofitimprurëse e cila ka si synim: 1.Aktivizimin e grave në shoqëri 2.Aktivizimin e të rinjve në zhvillimin lokal dhe nëpërmjet nxitjes së inciativave të punësimit 3. Agrikulturën dhe promovimin e produkteve lokale. 4. Trashëgiminë kulturore dhe artin. 5. Infrastrukturën dhe transportin. EULEUS u ngrit nga te rinjtë e qytetit ne vitin 2018. Prej 2018 e më sot ka bashkëpunuar si partnere me ojf të ndryshme në projekte të ndryshme.

b) Perfaqesues i medias per Bashkine Shijak eshte Miklovan Lugaj.

Kontaktet : cel 069 6588597

Email: mlugaj@gmail.com

Në Shijak nuk ka media lokale.

c) Prej disa vitesh qyteti i Shijakut është në fokus të projekteve të ndryshme nga ojf të ndryshme. Konkretisht aktulisht në bashkëpunim dhe me bashkinë Shijak, po bashkëpunon në disa projekte të ndryshme të fokusuar në integritetin e Bashkisë si dhe në fokus është trekëndëshi të rinjë-Bashki-prindër-të bashkalidhura me anë të shkollave.

Disa shembuj konkret:

1. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe STAR 3 (Mbështetja dhe Avancimi i Reformave të Qeverisjes Vendore) vlerësoi në shprehjen e interesit nga ana e bashkisë Shijak për tu bërë pjesë e procesit të planifikimit të integritetit në njësitë e qeverisjes vendore. Konkretisht projekti "Zgjerimi i praktikës standarde të planifikimit të integritetit në nivel vendor" synon zgjerimin e procesit të planifikimit të integritetit në nivel vendore. Qëllimi i tij konsiston në forcimin e etikës dhe integritetit në qeverisjen vendore si dhe ngritja e sistemeve efektive të menaxhimit të integritetit në nivel institucioni nëpërmjet hartimit dhe miratimit të instrumentit anti-korrupsion - Planit të Integritetit. Planifikimi i Integritetit është një proces vital që lejon qeverisjen vendore dhe banorëve që ajo përfaqëson të luftojnë sjelljet jo etikë, jo-profesionale dhe korruptive në institucion. Një Plan integriteti është një dokument operacional që drejton veprimtarinë e bashkisë drejt zhvillimit të nja administrate vendore të përgjegjshme, llogaridhënëse dhe transparente. Projekti përfshin tre faza të rëndësishme: 1) faza e vlerësimit të zbatimit të planeve të integritetit për 6 bashkitë pilote; 2) zhvillimi i planeve të integritetit në 14 bashki të vendit; 3) zhvillimi i një instrumenti monitorues të zbatimeve të planeve të integritetit-indeksi i integritetit; 4) fushate informuese mbi këtë praktike te planeve te integritetit me te gjitha bashkitë e vendit. Procesi i planifikimit të integritetit do të përfshijë këshillin bashkiak, stafin e bashkisë, organizata lokale dhe shoqata profesionale, si dhe anëtare të tjerë të komunitetit në krijimin e një dokumenti sa strategjik dhe operacional në luftën kundër korrupsionit në nivel vendor. IDM ka zhvilluar një metodologji dhe strukturë për të ndihmuar bashkitë në zhvillimin e këtij plani si dhe do të siguroj orientim dhe asistencë të vazhdueshme teknike nëpërmjet stafit të vet. Rezultat i gjithë kësaj pune do të jenë: një plan integriteti institucional kuptueshëm si dhe i mirë integruar, treguesit e performancës për të matur progresin si dhe një staf bashkie të mirë trajnuar për procesin e planifikimit të integritetit në mënyrë strategjike. Në kuadër të këtij projekti, kryetari i Bashkisë ngre një grup pune integriteti (GPI) për realizimin e vlerësimit të riskut në bashki. Grupi i punës kryesohet nga një koordinator. Nën drejtimin e tij/saj, grupi i punës merr detyrat për të gjithë procesin që lidhet me përgatitjen e regjistrit të risqeve dhe planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit. Ky grup u ngrit bazuar në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", "Strategjinë Sektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020" si dhe në lidhje me zbatimin e masave të vecanta të parashikuara në Planin e Veprimit 2018-2020 të miratuat me VKM Nr.241 , datë 20.04.2018 për zbatimin e strategjisë ndër-sektoriale kundër korrupsionit.
2. Me ojf Plan e Go ne Bashkëpunim me UNDP, gjithashtu janë ndërmarr dy nisma, si ndihma mesimore ndaj femijeve si rezultat i situates pandemike duke ofruar aktivitete mesimore dhe psiko-sociale me klasat ndihmuese dhe duke mbeshtetur familjet e prekura nga termeti por qe jane dhe njekohesishtë familje vulnerable, por jo vetem, ne kete fokus perfshihet dhe Qendra Komunitare e Fëmijëve me Aftësi Ndryshe, e cila kjo e fundit si godine eshte e themeluar dhe nga UNDP-ja.

3. Projekti: “Zgjerimi i rrjetit të komuniteteve të qëndrueshme në Shqipëri nëpërmjet modelitShkolla si Qendër Komunitare” zbatohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen financiare të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës së ShBA në Tiranë. Projekti ka për qëllim të fuqizojë komunitetet lokale të Shkodrës, Bulqizës, Mamurrasit, Prrenjasit, Rrogozhinës, Selenicës dhe Kamzës, në vijim të punës së bërë përgjatë tre viteve të fundit në Durrës, Shijak, Vorë, Krujë, Fushë-Krujë, Peqin, Cërrik dhe Kashar, në forcimin e qëndresës dhe parandalimin e radikalizimit që çon në çdo lloj forme të ekstremizmit të dhunshëm përmes masave parandaluese ndër-sektoriale. Në këtë drejtim, projekti do të ndërtojë një kuadër të qëndrueshëm ndër-sektorial midis aktorëve vendorë nën modelin Shkolla Qendër Komunitare (SHQK), duke i dhënë një theks të veçantë institucioneve arsimore dhe aftësimit të të rinjve për jetën, përmes ofrimit të trajnimeve tematike, nxitjes së pjesëmarrjes në vendimmarrjen lokale, rritjes së mundësive të punësimit dhe ndjenjës së përkatësisë në komunitet. Duhet theksuar se Bashkia Shijak është një model pozitiv i këtij projekti pasi jo vetem ka mbështetur të rinjtë por ka treguar që është një bashkëpuntor me shkollat.
4. Që prej 2018, është pjesë e projektit “ Bashki të Forta”. “Bashki të Forta” është një projekt i Swiss Development Cooperation, që zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation duke përfshirë 61 bashkitë e vendit. Faza e parë e këtij projekti do të vijojë deri në vitin 2022. Ky projekt synon që njerëzit në Shqipëri të përfitojnë në nivel vendor nga bashkitë e orientuara drejt qytetarëve dhe nga përmirësimimi i menaxhimit të mbetjeve dhe shërbimeve në sistemin parashkollor. Bashkitë do të mbështeten në përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e orientimit të menaxhimit drejt qytetarëve, veçanërisht lidhur me menaxhimin e mbetjeve, edukimin parashkollor, performancën e bashkive dhe këshillat bashkiakë. Pjesëmarrja më e madhe e qytetarëve është një element I domosdoshëm për t’i bërë administratat publike më të përgjegjshme dhe më efikase. Marrdhënia e qytetarit me institucionet shtetërore duhet të jetë e afërt, ata duhet të artikulojnë nevojat e tyre e të jenë pjesmarrës aktivë në vendimmarrje. Këshillat bashkiakë do të luajnë një rol kyç në pjesëmarrjen e qytetarëve, pasi ata zgjidhen nga këta qytetarë. Ata mbajnë fuqi të lartë mbi administraten e bashkisë. Reagimi i zbehtë i administratës lokale ndaj shqetësimeve dhe ankesave të qytetarëve, mund të kompensohet nga anëtarët e këshillave bashkiakë. Pjesmarrja qytetare përmes këshillave bashkiakë është pjesë zyrtare e politikave të shtetit shqiptar. Secili prej nesh duhet të jetë në gjendje për të përmbushur

   Me ndihmën e ketij projekti, për here të pare u ngrit komisioni i Barazisë Gjinore i cili ka ne fokus marrjen e inciativave qytetare dhe perkthimi i tyre ne zëra buxhetor të Bashkisë.

   Gjithashtu u ngrit dhe Aleanca e Grave dhe Vajzave këshilltare e përberë nga 11 gra e vajza që ka për qëllim fuqizimin e grave dhe vajzave këshilltare bashkiake dhe ndikimin e tyre në

   përmirësimin dhe hartimin e politikave lokale të favorshme për komunitetin, gratë dhe grupet e tjera të pafavorizuara në bashkinë përkatëse. Misioni i Aleancës është që të

bashkojë gratë dhe vazjat, anëtare të këshillave bashkiake në Shqipëri, nga të gjitha partitë politike dhe të punojë për të zhvilluar dhe advokuar për legjislacion, politikë dhe nisma të tjera që i përgjigjen çështjeve që prekin nevojat e grave dhe komuniteteve, rritjen e barazisë gjininore dhe përfshirjes sociale. Aleanca synon të promovojë barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale, të drejta të barabarta, qasjen e barabartë në shërbime dhe mundësi ekonomike në qeverisjen lokale.

d) Në Shijak, me mbështetjen e IDM-së, nje grup të rinjsh po synojnë ngritjen e një Këshilli Rinor. Ky grup të rinjsh ndjek mbledhjet e Këshillit Bashkiak por jo vetëm, sjell vazhdimisht problematikat nga terreni dhe sygjerimet e tyre per buxhetin e miratuar. Konkretisht në Dhjetor 2020, ky grup paraqiti një leter me kerkesa për të rinjtë që të përfshihen me shume ne buxhetin e Bashkisë.
Kërkesat që parashtruan ishin:
1. Krijimin e një klubi letrar
2. Ndërtimin e parqeve të gjelbëruara
3. Krijimin e kampeve verore
4. Ndërtimi i rrugëve për biçikleta
5. Krijimin e klubit rinor
6. Krijim e një biblioteke të re për qytetin
7. Ndërtimin e një pallati kulture të shkëputur nga xhamia
8. Krijimin e qendrave per te ofruar kurse falas
9. Vende te reja pune
10. Rritje e rolit të të rinjve në vendimarrje të qytetit.

7.3 Raporte , studime dhe vlersime mbi zbatimin e Programit te transparences .

Aktualisht nuk disponojme asnje raport raport , studime dhe vlersime mbi zbatimin e Programit te transparences .

7.4 Strukturat Komunitare. Perfshin berjen publike te :

a) Te dhena per strukturat komunitare ne fshat

b) Ne Bashkine Shijak nuk ka struktura komunitare ne qytet por vetem ne fshat

c)

Neni 1

Misioni i strukturave komunitare

1. Të përfaqësojnë interesat e komunitetit dhe grupeve të interesit të lagjes apo fshatit dhe të përcjellin interesat dhe nevojat e komunitetit pranë bashkisë dhe aktorëve të tjerë, duke mundësuar ushtrimin e autoritetit sa më afër qytetarit.
2. Të mbështesin bashkinë për një qeverisje sa më të efektshme dhe efikase, si dhe në një nivel sa më afër qytetarëve.
3. Të mbështesë zhvillimin vendor të udhëhequr nga komuniteti.
4. Të nxisin bashkinë për të reaguar në mënyrë efektive ndaj nevojave të komuniteteve.
5. Të nxisin dhe mbështesin ndërtimin e kulturës dhe praktikave të bashkëpunimit dhe komunikimit midis banorëve e bizneseve të lagjes apo fshatit dhe bashkisë.
6. Të promovojnë rrjetëzimin, të nxisin ndërveprimin dhe të inkurajojnë vullnetarizmin në lagje apo fshat, për të mobilizuar kontribute në funksion të rritjes së mirëqënies së komunitetit, arritjes së kohezionit social dhe zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të lagjes apo fshatit.
7. Të promovojnë dhe mbështesin bashkëjetesën, harmoninë në komunitet dhe kohezionin shoqëror, për të përmirësuar cilësinë e jetës në lagje apo fshat.
8. Të ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territori të lagjes apo fshatit.
9. Të zbusin polarizimin politik në komunitet.

Neni 2

Statusi i strukturave komunitare

1. Strukturat komunitare janë organizime vullnetare të komunitetit që ngrihen, zgjidhen dhe funksionojnë sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Strukturat komunitare janë të vetë-drejtuara, dhe të pavarura, përsa është e mundur.
3. Bashkia merr në konsideratë përgjigjen e kryesisë së fshatit apo këshillit komunitar për kërkesa dërguar atyre për këshilla, rekomandime apo reagime në lidhje me vendime apo projektet e bashkisë që i ndikojnë direkt fshatit apo lagjes.

4. Përgjatë ushtrimit të funksioneve dhe aktivitetit të tyre strukturat komunitare:

   a. Mund të mbështesin funksionet qeverisëse të Bashkisë në lagjen apo fshatin e tyre.[1]

   b. Zbatojnë urdhëresat, vendimet dhe urdhrat e Këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë,[2] për sa kohë Bashkia vë në dispozicion të tyre burime, financiare, njerëzore, materiale dhe teknologjike.

c. Vendosin vetë se cilat çështje janë të rëndësishme për lagjen apo fshatin që duan të përcjellin pranë Bashkisë, si dhe çfarë kontributi dëshirojnë të japin për vendimmarrësit e Bashkisë në lidhje me këto çështje.

d. Marrin në shqyrtim dhe i përgjigjen me shkrim kërkesave të bashkisë për këshilla, rekomandime, komente apo reagime

d) Rregullorja per organizimin dhe funksionimin e keshillave komunitare .

[1] Ligji nr. 139/2015, neni 69/1; 71/1.
[2] Ligji nr. 139/2015, neni 71/5.